

AKT THEMELIMI



I

SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE

"CHICKEN FARM" SH. A.

Neni 1

- Sokol Meqemeja, i biri i Luanit dhe i Lefteries, i dtl.28.06.1969, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. Kongresi i Lushnjes, me Pasaporten Nr. Z 1568441, me shtetesi e kombesi Shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- Hysen Ruka, i biri i Fahredinit, i dtl. 27.02.1960, lindur ne Kukes, banues ne Rr. Durresit, Tirane, me Pasaporte Nr. Z 2033353, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

sot me daten 07.02.2007, kane vendosur te themelojne Shoqerine "CHICKEN FARM" SH.A. ne perputhje me Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare", duke firmosur kete akt themelimi.

Neni 2

Shoqeria "CHICKEN FARM" SH.A. eshte nje Shoqeri Anonime me qender ne Kavaje. Adresa zyrtare e saj eshte: "CHICKEN FARM" SH.A, Agonas Kavaje.


Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte mbi 20 vjet.

Neni 4

Objekti i aktivitetit te shoqerise eshte :

Krijimi dhe menaxhimi i impianteve te rritjes, perpunimit, therrjes dhe tregetimit te pulave dhe mishit te pules apo te te gjitha kafsheve, mishi I te cilave tregtohen ne tregun vendas e te huaj.



Zhvillimi I teknologjive te reja ne fushen e rritjes, perpunimit, therrjes dhe tregtimit te pulave dhe mishit te pules apo te te gjitha kafsheve, mishi I cilave tregtohen ne tregun vendas e te huaj.

Import-eksport te ketyre produkteve, kryesisht pula te gjalla dhe ato te mishit te pules, te plota apo pjese te tyre, por edhe produkte te tjera te te gjitha kafsheve, mishi I te cilave tregtohen ne tregun vendas e te huaj, si psh. Mish viçi, derri, lope, etj.

Gjithashtu Shoqeria mund te kryeje aktivitet edhe ne fushen e prodhimit, import eksport te nenprodukteve te mishit te te gjithe llojeve te kafsheve si psh. sallameve, qofteve, kotoletave gjysem te gatshme te gatshme.

Import eksport te produkteve me te cilat ushqehen te gjitha llojet e kafsheve.

Prodhim dhe tregtim te produkteve me te cilat ushqehen te gjitha llojet e kafsheve.

Import eksport te makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per impiantet e rritjes, perpunimit, therrjes dhe tregtimit te pulave dhe mishit te pules apo te te gjitha kafsheve, mishi I te cilave tregtohen ne tregun vendas e te huaj.

Import eksport te makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per prodhimin e nenprodukteve te mishit te te gjithe llojeve te kafsheve si psh. sallameve, qofteve, kotoletave gjysem te gatshme etj.

Import eksport te makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per prodhimin e produkteve me te cilat ushqehen te gjitha llojet e kafsheve.

Furnizimin dhe tregtimin ne pikat e konsumit dhe tregjet e vendit te te gjithe produkteve qe permenden ne objektin e veprimtarise se Shoqerise.

Neni 5

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 2.000.000 lek i ndare ne 2.000 aksione nominative me vlere nominale 1.000 lek secili.

Kapitali Themeltar i Shoqerise, i ndare ne aksione per kontribut ne para eshte nenshkruar nga Aksioneret Themelues si me poshte:



Aksioneri Sokol Meqemeja 1000 (njemije) aksione, e barabarte me 50 % te kapitalit themeltar, si kontribut ne para.

Aksioneri Hysen Ruka 1000 (njemije) aksione, e barabarte me 50 % te kapitalit themeltar, si kontribut ne para.

Neni 6

Shoqeria do te administrohet nga Drejtoria, e cila do te perbehet nga nje anetar qe do te emerohet nga Keshilli Mbikqyres per nje periudhe 3-vjeçare. Statuti i Shoqerise percakton kompetencat e Drejtorise.

Neni 7

Organi Mbikqyres i Shoqerise eshte Keshilli Mbikqyres. Statuti i Shoqerise percakton kompetencat e Keshillit Mbikqyres. Ne perputhje me Nenin 93 te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992, per 3 vitet e para, anetaret e Keshillit Mbikqyres jane ata te percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

Neni 8

Viti i pare financiar i Shoqerise do te filloje me regjistrimin e Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe do te mbaroje ne 31 Dhjetor 2007.

Neni 9

Ky Akt Themelimi perbehet nga 9 nene. Ai eshte pergatitur ne kater kopje.

Ky Akt Themelimi eshte firmosur me date 07/02/2007, nga Aksioneret Themelues te Shoqerise Sokol Meqemeja dhe Hysen Ruka.

AKSIONERET THEMELUES

Sokol Meqemeja

Hysen Ruka



STATUT

I

SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE

"CHICKEN FARM" SH. A.

Neni 1

Emri dhe Forma Ligjore

Shoqeria *"CHICKEN FARM" SH.A.*, eshte nje Shoqeri Anonime pa oferte publike ne perputhje me Ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Aksioneret themelues te shoqerise jane:

- Sokol Meqemeja, i biri i Luanit dhe i Lefteries, i dtl.28.06.1969, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. Kongresi i Lushnjes, me Pasaporten Nr. Z 1568441, me shtetesi e kombesi Shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- Hysen Ruka, i biri i Fahredinit, i dtl. 27.02.1960, lindur ne Kukes, banues ne Rr. Durresit, Tirane, me Pasaporte Nr. Z 2033353, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2

Selia e Shoqerise

Selia e Shoqerise do te jete ne Agonas, Kavaje.

Neni 3



Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë është mbi 20 vjet.

Neni 4

Objekti i Aktivitetit

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Krijimi dhe menaxhimi i impianteve të rritjes, perpunimit, therrjes dhe tregimit të pulave dhe mishit të pulës apo të të gjitha kafsheve, mishi I të cilave tregohen në tregun vendas e të huaj.

Zhvillimi I teknologjive të reja në fushën e rritjes, perpunimit, therrjes dhe tregimit të pulave dhe mishit të pulës apo të të gjitha kafsheve, mishi I të cilave tregohen në tregun vendas e të huaj.

Import-eksport të këtyre produkteve, kryesisht pula të gjalla dhe ato të mishit të pulës, të plotë apo pjesë të tyre, por edhe produkte të tjera të të gjitha kafsheve, mishi I të cilave tregohen në tregun vendas e të huaj, si psh. Mish viçi, derri, lope, etj.

Gjithashtu Shoqëria mund të kryejë aktivitet edhe në fushën e prodhimit, import eksport të nenprodukteve të mishit të të gjithë llojeve të kafsheve si psh. sallameve, qofteve, kotoletave gjysem të gatshme të gatshme.

Import eksport të produkteve me të cilat ushqehen të gjitha llojet e kafsheve.

Prodhim dhe tregim të produkteve me të cilat ushqehen të gjitha llojet e kafsheve.

Import eksport të makinerive dhe mjeteve që shërbejnë për impiantet e rritjes, perpunimit, therrjes dhe tregimit të pulave dhe mishit të pulës apo të të gjitha kafsheve, mishi I të cilave tregohen në tregun vendas e të huaj.



Import eksport te makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per prodhimin
nepenprodukteve te mishit te te gjitha llojeve te kafsheve si psh. sallameve,
qeqe, kotoletave gjysem te gatshme etj.

Import eksport te makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per prodhimin
e produkteve me te cilat ushqehen te gjitha llojet e kafsheve.

Furnizimin dhe tregtimin ne pikat e konsumit dhe tregjet e vendit te te gjitha
produkteve qe permenden ne objektin e veprimtarise se Shoqerise.

Neni 5

Deget

Ne kryerje te aktivitetit te saj, Shoqeria mund te hape dege dhe zyra
perfaqesimi kudo brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

Neni 6

Kapitali

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 2.000.000 lek i ndare ne 2.000
aksione nominative me vlere nominale 1.000 lek secili.

Kapitali Themeltar i Shoqerise, i ndare ne aksione per kontribut ne
para eshte nenshkruar nga Aksioneret Themelues si me poshte:

Aksioneri Sokol Meqemeja 1000 (njemije) aksione, e barabarte me 50
% te kapitalit themeltar, si kontribut ne para.

Aksioneri Hysen Ruka 1000 (njemije) aksione, e barabarte me 50 % te
kapitalit themeltar, si kontribut ne para.

Neni 7

Zmadhimi i Kapitalit

Asambleja e Jashtezakoneshme e Aksionereve, do te kete te drejten te
beje zmadhimin e kapitalit kohe pas kohe me qellim qe te permbushe
objektivat e Shoqerise.

Kapitali Themeltar zmadhohet vetem nepermjet emetimit te aksioneve
te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese.
Aksionet e reja shlyhen me para ne dore ose me kontribut ne natyre.

Ne rast te zmadhimit te Kapitalit me kontribute ne natyre, me vendim te Gjykates kompetente, emerohet nje ose me shume Eksperte Vleresues, te cilet do te percaktojne vleren e ketij kontributi, ne baze te Ligjit Nr. 7638 "Per Shoqerite Tregtare".

Zmadhimi I Kapitalit Themeltar te Shoqerise duhet te realizohet brenda 5 (pese) vjetesh nga dita kur Asamblea e Jashtezakonshme e Aksionereve ka miratuar kete zmadhim.

Neni 8

Zvogelimi I Kapitalit

Zvogelimi I Kapitalit autorizohet ose vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve. Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve qe thirret per zvogelimin e Kapitalit te Shoqerise, dorezohet raporti I arsyetuar I Drejtorise, ne te cilin spjegohen arsyet qe bejne te detyrueshem marrjen e vendimit perkates.

Ne te gjitha rastet, zvogelimi I prek aksioneret ne te njejten mase ne perpjestim me vleren e aksioneve qe ata zoterojne ne Shoqeri.

Projekti I Zvogelimit te Kapitalit, u komunikohet Eksperteve Kontabel te Autorizuar, te pakten 45 (dyzet e pese) dite para mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve, qe thirret per te vendosur mbi kete projekt.

Neni 9

Transferimi i Kapitalit

Aksionet e Shoqerise mund te transferohen lirisht nepermjet rruges se trashegimise midis ^{aksionereve} ortakëve, ndersa ne drejtime te tjera ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Aksionet e Shoqerise mund te transferohen tek te tretet qe nuk jane pjestare te kesaj Shoqerie, vetem kur Asamblea e Aksionereve vendos me aprovimin e shumices se aksionereve qe perfaqeson te pakten 3/4 e kapitalit themeltar. Cilido Aksioner qe do te transferoje pjesen e tij te aksioneve ndaj te treteve, duhet t'i ofroje me pare ato, nepermjet nje leter rekomande Aksionereve te Shoqerise, sepse ata kane te drejten e parablerjes ne proporcion me pjeset e tyre te kapitalit. Vlera e aksioneve fiksohet me vleren ne daten e shitjes. Oferta per shitje duhet te permbaje sasine e aksioneve qe do te transferohen, çmimin respektiv dhe menyren e pageses.



Ne rastin kur oferta e aksioneve nuk blihet e gjitha nga Aksioneret jo me gjate se nje muaj nga dita e ofertes, shitesi ka te drejten te shese aksionet te pashtura ndaj te treteve me kushtin qe çmimi i shitjes te jete jo me i ulet se çmimi i ofruar aksionereve te Shoqerise. Ne rast te kundert oferta eshte e pavlefshme dhe duhet te perseritet nga e para.

Ndryshimet ne kapitalin themeltar te aksionereve duhet te çertifikohet ne Zyren e Noterise.

Neni 10

Asambleja e Zakonshme e Aksionereve

Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Asambleja e Aksionereve, e cila perbehet nga te gjitha Aksioneret e Shoqerise.

Neni 11

Kompetencat

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Aksionereve do te perfshijne te gjitha ato te percaktuara nga ligji Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ky Statut.

Neni 12


Mbledhjet

Asambleja e Shoqerise do te mbaje te pakten nje Mbledhje vjetore te Aksionereve te Shoqerise, ne Zyrat e Shoqerise, ose ne nje vend tjeter, brenda 6-mujorit te pare te çdo viti kalendarik.

Njoftimi per nje mbledhje te tille, ku do te percaktohet rendi i dites, koha dhe vendi i mbajtjes se saj, duhet bere te pakten 15 dite perpara, ne forme te shkruar, çdo aksioneri, ne adresen perkatese qe rezulton ne Librin e Aksionereve.

Mosrespektimi i rregullave te mesiperme shkakton pavlefshmerine e mbledhjes. Mbledhja do te konsiderohet e vlefshme edhe ne rastin kur njoftimi nuk eshte bere por i gjithë kapitali aksioner perfaqesohet dhe bie dakort keshtu.

Pavaresisht nga Mbledhja Vjetore, Mbledhja e rregullt e Aksionereve mund te thirret ne çdo kohe nga Drejtoria, Ekspertet e Autorizuar te Shoqerise, nga Likujdatori i Shoqerise, Keshilli Mbikqyres, ose nepermjet



nje mandatmbajtesi te caktuar me gjyq, mbi nje kerkese te nje ose me shume aksionereve qe kontrollojne te pakten 1/10 e kapitalit te Shoqerise. Lajmerimi per kete mbledhje, ku do te percaktohet koha, vendi, rendi i dites, do tu behet Aksionereve sipas menyres se percaktuar per thirrjen e Mbledhjes Vjetore.

Neni 13

Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve

Drejtoria mund te therrase Asamblene e Jashtezakonshme te Aksionereve ne çdo kohe. Nje mbledhje e jashtezakonshme mund gjithashtu te thirret nga Ekspertet e Autorizuar te Shoqerise. Lajmerimi per kete mbledhje, ku do te percaktohet koha, vendi, rendi i dites, do tu behet Aksionereve sipas menyres se percaktuar per thirrjen e Mbledhjes Vjetore. Vetem Asambleja e Jashtezakonshme e Shoqerise ka kompetenca te ndryshoje Statutin me te gjitha dispozitat e tij.

Neni 14

Shumica dhe Marrja e Vendimeve ne Mbledhje

Per Asamblene e Zakonshme te Aksionereve, mbledhja do te jete e vlefshme kur aksioneret prezent në të, kontrollojne te pakten 25% te kapitalit themeltar. Ne keto mbledhje te konstituara vlefshmerisht, vendimet do te merren me voten aprovuese te shumices se aksioneve te perfaqesuara ne mbledhje.

Nese shumica e permendur me lart nuk arrihet, mbledhja do te shtyhet per nje date te mevonshme jo me vone se nje muaj nga data fillestare. Ne kete rast nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Vendimet e Asamblese se zakonshme merren me shumicen e thjeshte te votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Per Asamblene e Jashtezakonshme te Aksionereve, mbledhja do te jete e vlefshme kur aksioneret prezent në të, kontrollojne te pakten 50% te kapitalit themeltar.

Nese shumica e permendur nuk arrihet, mbledhja do te shtyhet per nje date te mevonshme jo me vone se nje muaj nga data fillestare. Ne kete rast do te kerkohet nje shumice prej 25 % te aksioneve.

Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme merren me nje shumice votash prej 3/4 qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.





Neni 15

Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjidhet nga Asambleja e Aksionereve dhe ushtron kontroll te vazhdueshem per menyren ne te cilen Drejtoria administron Shoqerine. Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe veprime verifikimi dhe kontrolli. Per kryerjen e detyrave te tij ai mund te kerkoje te vihet ne dijeni me mjetet dhe dokumentat e domosdoshme. Keshilli Mbikqyres do te kete te gjitha kompetencat e percaktuara ne nenet 103, 122, 123 te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992.

Neni 16

Perberja e Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 anetare. Anetaret e Keshillit Mbikqyres do te zgjidhen per nje periudhe 3-vjeçare te rinovueshme.


Neni 17

Keshilli Mbikqyres nuk mund te marre vendime te vlefshme, pa qene e pranishme te pakten gjysma e anetareve te tij. Ne keto mbledhje te konstituara vlefshmerisht, vendimet merren me aprovimin e shumices se anetareve pjesemarres.

Neni 18

Ne baze te nenit 93 te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 per 3 vitet e para anetare te Keshillit Mbikqyres do te jene:

- **Sokol Meqemeja**, i biri i Luanit dhe i Lefteries, i dtl.28.06.1969, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. Kongresi i Lushnjes, me Pasaporten Nr. Z 1568441, me shtetesi e kombesi Shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

 **Hysen Ruka**, i biri i Fahredinit, i dtl. 27.02.1960, lindur ne Kukes, banues ne Rr. Duresit, Tirane, me Pasaporte Nr. Z 2033353, me shtetesi dhe kombesi Shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Fatmir Rama, i biri i Kasapit dhe Rushes, I dtl.27.03.1958, lindur ne Kukes e banues ne Rr Komuna e Parisit, Blloku D, Pall 2,Shk 1, ap 2/4, Tirane, me shtetesi e kombesi Shqiptare, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 19

Administrimi i Shoqerise Drejtoria

Aktiviteti dhe biznesi i Shoqerise do te administrohen nga Drejtoria, e cila do te ushtroje aktivitetin e saj nen kontrollin e Keshillit Mbikqyres.

Neni 20

Drejtoria perbehet prej nje anetari te emeruar nga Keshilli Mbikqyres per nje periudhe 3-vjeçare. Keshilli Mbikqyres ka kompetencen per te emeruar Drejtorin e Pergjithshem dhe te emeroje zevendesuesin e anetarit te Drejtorise ne rast pengese, vdekjeje etj.

Anetar i Drejtorise eshte:

Marenglen Meqemeja, I biri I Ahmetit dhe I Nadjas, lindur me 10.07.1978 e banues ne Tirane, me Çertifikate Lindje Nr. 379 042564, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi e shtetesi Shqiptare.

Neni 21

Mbledhjet e Drejtorise

Mbledhjet e Drejtorise mund te mbahen çdo tre muaj, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise. Mbledhjet e Drejtorise mund te mbahen me ose pa njoftim, ne vendin dhe kohen qe do te percaktoje Drejtoria ne çdo rast.





Neni 22

Mbledhja do të konsiderohet e konstituuar vlefshmerisht kur shumica e drejtoreve janë prezente në të. Nëse një shumicë e tillë nuk sigurohet, drejtoret prezente do të shtyjne mbledhjen kohe pas kohe derisa kjo shumicë të sigurohet.

Neni 23

Çdo veprim i kerkuar apo i lejuar për tu kryer në Mbledhjen e Drejtorisë mund të kryhet pa mbledhjen e saj nëse pelqimi në formë të shkruar për vendimin që autorizon veprimin, i marrë në këto formë, do të firmoset nga të gjithë Drejtoret me të drejtë vote në lidhje me çështjen e mesipërme.

Neni 24

Drejtori i Pergjithshem

Vendimet e administrimit të përditshëm do të merren nga Drejtori në përputhje me kompetencat perkatese të percaktuara nga Keshilli Mbikqyres. Drejtor i Pergjithshem i Shoqërisë është z. **Marenglen Meqemeja**.

Neni 25

Marreveshjet e ndaluara dhe marreveshjet që kërkojnë autorizim

Anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe të Drejtorisë (Drejtori i Pergjithshem) u ndalohej që të kontrahojnë që të marrin hua nga Shoqëria, t'u akordohet llogari rrjedhese ose në një formë tjetër, dhe të bëjnë Shoqërinë dorezanese apo garante për detyrimet e tyre ndaj të tjerëve.

Çdo marreveshje ndërmjet Shoqërisë dhe njerit nga anetaret e Keshillit Mbikqyres ose Drejtorisë, që lidhet drejteperdrejte ose terthorazi (me ndërmjetesim), duhet të autorizohet paraprakisht nga Keshilli Mbikqyres (nga Kryetari, apo jo me pak se tre anetare të këtij Keshilli).



Neni 26

Kontabiliteti dhe financat e shoqerise Aftesia paguese

Shoqeria krijon marzhin e aftesise paguese te mjaftueshme per veprimtarine e saj, duke perfshire te gjithe vleren e pasurive, si kapitalin themeltar, rezervat, fitimet e mbartura, etj.

Neni 27

Bilanci vjetor

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat e ligjit. Per ndjekjen e gjendjes financiare Drejtori i Pergjithshem, sipas struktures dhe permbajtjes te percaktuar ne planin kontabel, pergatit raportin mbi gjendjen financiare çdo tremujor si dhe ate vjetor.

Ne mbylljen e çdo viti financiar hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore per kontabilitetin, si dhe raportin vjetor mbi gjendjen financiare te Shoqerise gjate vitit te kaluar, ku parashikohen dhe ndryshime per te ardhmen e veprimtarite e tjera te Shoqerise.

Keto dokumenta i jepen ekspertit kontabel nje muaj perpara mbledhjes se Asamblese se Aksionereve, i cili ben komentet e veta ne nje raport te veçante.

Neni 28

Miratimi i bilancit

Raporti mbi gjendjen financiare te Shoqerise, i detajuar per te gjitha operacionet dhe per gjendjen e administrimit te Shoqerise paraqitet nga Drejtori i Pergjithshem ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres, i cili e miraton dhe ia paraqet Asamblese se Zakonshme te Aksionereve.



Neni 29

Rezultati i ushtrimit financiar dhe rezervat

Rezultati i ushtrimit financiar percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire ne keto te fundit edhe amortizimet, provizionet dhe taksat.

Nga fitimet e ushtrimit, te pakesuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5% per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 15% te kapitalit themeltar.

Asambleja e Zakonshme ne rast nevojje mund te formoje edhe fonde te tjera. Shuma e fitimeve te mbetura pas krijimit te rezervave si me siper, perfaqeson dividendin.

Aksioneret kane te drejte te marrin pjesen e fitimit te destinuar per ndarje nga Asambleja e Zakonshme, proporcionalisht me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 30

Pergjegjesite ndaj Shtetit

Shoqeria ka llogarite e saj bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet e tjera ndaj Shtetit.


Neni 31

Ekspertet kontabel

Asambleja e Pergjithshme, duke vepruar ne Mbledhjen Vjetore, do te emeroje ekspertin e jashtem te pavarur i cili duhet te jete ekspert kontabel i autorizuar.

Ekspertet kontabel jane te autorizuar qe ne çdo kohe te vitit te bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe gjykojne te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne te gjitha dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushtrimin e funksionit te tyre, ne veçanti, kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe rregjistrat e proces-verbaleve.

Detyrat dhe te drejtat e eksperteve kontabel te pavarur te Shoqerise jane ato te parashikuara nga Ligji Nr.7638 "Per shoqerite tregtare".

 Ekspertet kontabel informojne Keshillin Mbikqyres dhe Drejtorin e Pergjithshem per :

- kontrollin, verifikimet dhe sondazhet qe kane kryer,
- pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ku ata kane verejtje,
- parregullsite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.

Ekspertet kontabel thirren ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres kur mbyllet llogarite e vitit financiar si dhe ne mbledhjen e Asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj Shoqerise, ashtu edhe ndaj te treteve per pasojat qe rrjedhin per fajin e nenvleftesimin e tyre gjate ushtrimit te funksioneve qe kane.

Honoraret e eksperteve i ngarkohen Shoqerise. Keshilli Mbikqyres, me rastin e miratimit te eksperteve, miraton edhe masen e shperblimit te tyre.

Marredheniet e eksperteve kontabel me Shoqerine percaktohen ne nje kontrate midis tyre dhe Drejtorit te Pergjithshem.

Neni 32

Ne perputhje me Nenin 93 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 per periudhen e pare nje vjeçare ekspert i emeruar eshte znj. Lefteri Kushta.

Neni 33

Likujdimi

Shperndarja e Shoqerise mund te behet ne çdo kohe, kur per shkaqe te ndryshme nuk mund te vazhdoje aktivitetin e saj. Ne kete rast ajo vihet ne likujdim.

Likujdimi behet ne pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.7638 "Per Shoqerite Tregtare" e te Ligjit "Per proceduren e falimentimit".

Asambleja e Jashtezakonshme e aksionereve cakton likujdatorët duke percaktuar edhe kompetencat qe ata kane.

Neni 34

Shkrirja dhe Bashkimi

Shoqeria mund te shkrihet dhe bashkohet me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve.





Neni 35

Dispozitat e Fundit

Te gjitha problemet qe nuk jane percaktuar ne kete Statut do te jene subjekt i rregullimeve te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", siç parashikohen aktualisht apo siç ato mund te ndryshohen me vone.

Neni 36

Ky Statut perbehet nga 36 nene. Ai eshte pergatitur ne kater kopje.
Ky Statut eshte firmosur me date 07/02/2007, nga Aksioneret Themelues te Shoqerise Sokol Meqemeja dhe Hysen Ruka.

AKSIONERET THEMELUES

Sokol Meqemeja

Hysen Ruka